



**KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS**

**I.Numër: 400/01-97930, dt: 30 Dhjetor 2024**

Në bazë të nenit 11 dhe 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit nr.06/L-092 mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Numër: 01-016/01-413431 dt.30 shtator 2020, pasi shqyrtoi propozimin e Kryetarit të Komunës për Miratimin e Këmbimit e Pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronares private Ryve (Halit) Muqolli, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur më datë: 30 Dhjetor 2024, nxjerr këtë:

**VENDIM  
Nr. 70/2024**

**Mbi Miratimin për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Ryve (Halit) Muqolli me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e Shtratit të Lumbardhit dhe Hapjen e Shetitores.**

- I. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës për Këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private me qëllim të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimin e Shtratit të Lumbardhit dhe Hapjen e Shetitores.
- II. Parcelat kadastrale nr.2296-3 në sipërfaqe prej 11m<sup>2</sup> ZK Pejë dhe nr.6303-1 në sipërfaqe prej 61m<sup>2</sup> ZK Pejë në pronësi të Ryve Muqollit do të merren për nevoja të përmbushjes së Interesit Publik: Rregullimi i Shtratit të Lumbardhit dhe hapja e Shetitores, dhe në të njëjtën kohë do të jetë objekt këmbimi me parcelën kadastrale nr.3428-2 në sipërfaqe prej 71m<sup>2</sup> ZK Pejë pronë Komuna Pejë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë Vlerësimet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Departamenti i Tatimit në Pronë të aprovuara me datën 06.12.2024.

*-Prona e Komunës, ngastra kadastrale nr. 3428-2 në sipërfaqe prej 71m<sup>2</sup> ZK Pejë është vlerësuar 435.00 €/m<sup>2</sup> që i bie totali 30,885.00 €.*

*- Pronat private të Ryve Muqollit, ngastra kadastrale nr.2296-3 në sipërfaqe prej 11m<sup>2</sup> ZK Pejë është vlerësuar 430,00 €/m<sup>2</sup> që i bie totali 4,730.00 €, ndërsa ngastra kadastrale me nr. 6303-1 në sipërfaqe prej 61m<sup>2</sup> është vlerësuar me 430.00 €/m<sup>2</sup> që i bie totali 26,230.00 €. Në total, këto dy prona janë vlerësuar në shumën prej 30,960.00 €.*

*-Ashtu që Komuna e Pejës obligohet që t'ia kompenzoj Ryvë Muqollit diferencën në shumën prej 75.00 €.*

- IV. Kjo procedurë e Këmbimit do t'i nënshtrohet Vlerësimit të Ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

- V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Çështje Pronësoro–Juridike.
- VI. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në Web faqen e Komunës së Pejës.

**Vendimi ti dërgohet:**  
MAPL-së,  
Kryetarit të Komunës,  
DÇPJ,  
Arkiv.

